



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina

KRYETARI I KRYEQYTETIT

14-020105-107437/24, më 15 AUG 2024

Në bazë të neneve 13 dhe 58 të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale, të nenit 53 të Statutit të Komunës së Prishtinës 01. nr. 110 - 391, të dt. 25.02.2010, Kryetari i Kryeqytetit, merr këtë:

V E N D I M

1. **NDALOHET** qarkullimi i mjeteve motorike në rrugën "Fehmi Agani" nga kryqëzimi me rrugën "Migjeni" deri te kryqëzimi me rrugën "UÇK".
2. Sipas pikës 1 të këtij vendimi, ndalimi i qarkullimit të mjeteve motorike bëhet deri me datën 31.08.2024, nga ora 21:00 deri në orën 02:00.
3. Ndalimi i qarkullimit nuk përfshin mjetet motorike me rëndësi të veçantë dhe mjetet për intervenime të ndryshme nga institucionet kompetente të sigurisë si Policia e Kosovës, inspekcioni, automjetet emergjente, transportit me taksi si dhe banorët e lagjes.
4. Obligohet Drejtoria e Shërbimeve Publike që të vendosë shenjat vertikale përkatëse për ndalimin e qarkullimit, me tabelë plotësuese nga ora 21:00 deri në orën 02:00.
5. Zyra për marrëdhënie me publikun do t'i njoftoj qytetarët dhe subjektet tjera për këtë vendim, përmes mediave të shkruara dhe elektronike.
6. Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi, shfuqizohet Vendimi nr. 14-343/01-103472/24 i dt. 07 Gusht 2024.
7. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të tij.

U DORËZOHET:

- Drejtorisë së Shërbimeve Publike;
- Drejtorisë së Inspekcioit;
- Policisë së Kosovës;
- Zyrës për marrëdhënie me publikun;
- Qendrës për shërbim me qytetarë;
- Në dosje.

KRYETARI I KRYEQYTETIT
Përparim Rama

